

Vendim nr. 12 datë 24.05.2022

(V-12/22)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.05.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 4 (F) 2021 Akti të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: FLAMUR HAKA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PROKURORIA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 87, datë 29.01.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 99, datë 08.04.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2021-449, datë 22.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i aktit normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, i ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 27, 28, 31, 33, 42, 101, 131, pika 1, shkronjat “c” dhe “f”, 134, pika 1, shkronja “r”, 135, pika 2, 145, pika 2 dhe 148, shkronja “dh”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4 dhe 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi i Shqipërisë*) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës për pjesën e pretendimeve që lidhen me antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020 dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), e cila ka kërkuar refuzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar Flamur Haka është proceduar dhe dënua penalisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. 961, datë 30.12.2002 e ka deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “Vjedhja me dhunë”, në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 139, 22 dhe 278, paragrafi 2, të Kodit Penal (*KP*). Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 209, datë 11.04.2003. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 381, datë 04.07.2003, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuar.

2. Gjithashtu, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 13, datë 18.02.2008, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese”, e kryer në bashkëpunim, “Vrasja me paramendim”, për hakmarrje, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 109/a, 25, 78, paragrafi 2, 22, 25, 23, paragrafi 2 dhe 278, paragrafi 2, të KP-së. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 58, datë 22.10.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 656, datë 18.06.2010, nuk e ka pranuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi.

3. Këshilli i Ministrave ka nxjerrë aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike” (*akti normativ nr. 1/2020*), me efekt të përkohshëm deri në datën 31.12.2020.

4. Në datën 05.03.2020 Kuvendi i Shqipërisë, mbështetur në nenet 78 dhe 101 të Kushtetutës, ka miratuar ligjin nr. 18/2020 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 31.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

5. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 35, datë 16.12.2020 “Për një shtesë në aktin normativ nr. 1, datë 31.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, miratuar me ligjin nr. 18/2020” (*akti normativ nr. 35/2020*), nëpërmjet të cilit ka shtyrë kohën e shtrirjes së efekteve të aktit normativ nr. 1/2020, duke përcaktuar “*vazhdimin e shqyrtimit nga prokuroria dhe gjykata të kërkesave të depozituara nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në datën 31.12.2020*”. Ky akt është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 5/2021, datë 05.01.2021.

6. Në zbatim të aktit normativ nr. 1/2020, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me qëllim garantimin e sigurisë publike dhe parandalimin e rrezikut për cenimin e saj, i ka parashtruar Prokurorisë së Posaçme, në datën 31.12.2020, nevojën për caktimin e masës parandaluese personale ndaj kërkuesit, për shkak të dyshimit të ngritur për mundësinë e pjesëmarrjes së tij në kryerjen e krimeve të rënda.

7. Në datën 27.01.2021 Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*) caktimin e masës parandaluese me natyrë personale të kufizimit të perimetrit të lëvizjes për kërkuesin në hapësirën brenda fshatit Zezë, njësia administrative Nikël, Krujë, për një afat deri në 1 (një) vit.

8. Me vendimin nr. 87, datë 29.01.2021, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur, në dhomë këshillimi, pranimin e kërkesës, me arsyetimin se ishte e përligjur dhe në raport të drejtë me dyshimin e krijuar.

9. Me prokurën e posaçme nr. 1136 rep., nr. 607 kol., datë 16.02.2021, të lëshuar në Fushë Krujë prej noterit (*prokura e posaçme e datës 16.02.2021*), kërkuesi ka emëruar avokatin Arben Qeleshi dhe avokaten Joana Qeleshi për përfaqësimin në çdo fazë të hetimit dhe të gjyqimit në mbrojtje të të drejtave të tij.

10. Kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësve ligjorë, në datën 12.03.2021 ka paraqitur ankim, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe pezullimin e gjyqimit, si dhe referimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për kontrollin e kushtetutshmërisë së aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar. Ankimi është nënshkruar vetëm nga mbrojtësit ligjorë.

11. Gjatë gjyqimit të ankimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), kërkuesi, për shkak të aplikimit të masës parandaluese të kufizimit të perimetrit të lëvizjes, nuk ka marrë pjesë personalisht, por ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësit e zgjedhur me prokurën e posaçme të datës 16.02.2021. Në seancën e datës 29.03.2021, GJKKO-ja e Apelit, pasi ka konstatuar mungesën e prokurës së posaçme, ka vendosur shtyrjen e seancës në datën 08.04.2021, me qëllim dhënien e mundësisë mbrojtësve ligjorë të kërkuesit për të rregulluar këtë të metë. Në kushtet kur edhe në seancën e datës 08.04.2021, nga mbrojtësit ligjorë nuk u arrit të paraqitej prokura e posaçme, GJKKO-ja e Apelit, bazuar në nenin 10 të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar dhe nenin 450, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), me vendimin nr. 99, datë 08.04.2021, ka vendosur mospranimin e ankimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi nëpërmjet njërit prej mbrojtësve ligjorë të tij.

12. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-449, datë 22.06.2021, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

13. Me shkresën nr. 3925/1 prot., datë 18.11.2021, kancelari i Gjykatës së Lartë ka informuar kërkuesin se informacioni për përfundimin e çështjes është publikuar brenda datës 22.06.2021, ndërsa vendimi përfundimtar është publikuar në datën 23.07.2021.

14. Kërkuesi në datën 23.11.2021 i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve nr. 87, datë 29.01.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, nr. 99, datë 08.04.2021 të GJKKO-së së Apelit dhe nr. 00-2021-449, datë 22.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

15. Në datën 02.02.2022 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 21, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

16. Me shkresën nr. 2815/1 prot., datë 12.04.2022, Prokuroria e Posaqme ka informuar Gjykatën se ekzekutimi i vendimit nr. 87, datë 29.01.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë është përmbushur në datën 17.02.2021.

17. Në datën 20.05.2022 Komisariati i Policisë Krujë i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës ka informuar në rrugë elektronike se efektet e masës së sigurimit personal të kufizimit të lëvizjes së vendosur ndaj kërkuesit kanë përfunduar në datën 16.02.2022.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

18. **Kërkuesi** ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur se:

A. *Nga vendimet gjyqësore* i është cenuar:

18.1. *E drejta për akses në gjykatë, për të marrë pjesë në proces dhe për t'u dëgjuar*, pasi gjykimi në GJKKO-në e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomë këshillimi, kurse GJKKO-ja e Apelit, duke mos e shqyrtuar ankimin, i ka mohuar edhe *të drejtën e ankimit*. Kjo e fundit kishte detyrimin të bënte një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi faktin nëse ishte lëshuar ose jo prokurë, duke qenë se sekretaria e GJKKO-së së Shkallës së Parë e kishte pranuar

ankimin dhe kishte kryer veprimet përkatëse të përcjelljes së ankimit. Kërkuesi, duke qenë nën masën e kufizimit të perimetrit të lëvizjes, pavarësisht dëshirës së tij, e kishte të pamundur objektivisht paraqitjen në seancë pa një fletëthirrje zyrtare nga gjykata. Po kështu, e njëjta prokurë e posaçme i është bashkëlidhur edhe rekursit të depozituar në Gjykatën e Lartë, çka duhet të ishte e mjaftueshme për këtë gjykatë për të konkluduar se ankimi ishte paraqitur nga mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi dhe se kërkuesi nuk kishte mundësi që të dëgjohej dhe të mbrohej përpara GJKKO-së së Apelit.

- 18.2. *E drejta për liri dhe siguri*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi mungojnë kushtet për legjitimimin e kufizimit, duke qenë se masa e kufizimit të lëvizjes jepet vetëm në kuadër të një procesi penal.
- 18.3. *E drejta e mbrojtjes efektive*, pasi Gjykata e Lartë kishte detyrimin të konstatonte shkeljen e së drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor dhe si gjykatë ligji kishte të drejtën të konstatonte edhe kryesisht shkeljet e rënda të normave procedurale.

B. Akti normativ nr. 1/2020, i ndryshuar me aktin normativ nr. 35/2020 ka cenuar:

- 18.4. *Kërkesat kushtetuese të vlefshmërisë*, pasi ka dalë në kundërshtim të përcaktimeve të nenit 101 të Kushtetutës, duke qenë se mungojnë kushtet e nevojës (boshllëkut legjislativ) dhe urgjencës.
- 18.5. *Parimin e ndarjes së pushteteve*, të garantuar nga neni 7 i Kushtetutës, pasi Këshilli i Ministrave nëpërmjet nxjerrjes së aktit normativ me fuqinë e ligjit, duke zgjeruar kompetencat e prokurorisë dhe gjykatës, ka marrë kompetencat e Kuvendit.
- 18.6. *Hierarkinë e akteve normative*, të parashikuar nga neni 116 i Kushtetutës, pasi akti normativ i miratuar me shumicë të thjeshtë ka zgjeruar kompetencat e prokurorisë përtej atyre të parashikuara nga Kushtetuta dhe përmban rregulla procedurale të ushtrimit të veprimtarisë së prokurorisë dhe gjykatës, të cilat, bazuar në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, miratohen me shumicë të cilësuar.
- 18.7. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi krijon mbivendosje ndërmjet kompetencave të organeve dhe parashikimeve të normave ligjore, si dhe bie në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese. Në funksion të këtij parimi, akti normativ nuk

përmban garancitë kushtetuese që parashikon ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar (ligji nr. 10192/2009).

- 18.8. *Parimin e gjykatës së krijuar me ligj*, pasi ka zgjeruar kompetencën lëndore të prokurorisë dhe gjykatës së posaçme, duke i dhënë attribute për të kërkuar dhe për të vendosur lidhur me masat parandaluese me karakter pasuror, jo vetëm ndaj subjekteve të dënuar ose të dyshuar për krim të organizuar, por edhe ndaj atyre të dënuar, ose të dyshuar për krime të tjera, që nuk janë në kompetencë të kësaj gjykate. Në këtë drejtim parashikimet e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar tejkalojnë dhe krijojnë një mbivendosje kundërthënëse me parashikimet e ligjit nr. 10192/2009, pasi ndryshojnë kompetencën lëndore të organit që procedon në rastin e masave parandaluese me karakter pasuror.
- 18.9. *Parimin e pavarësisë së prokurorit*, të garantuar nga neni 148, pika 2, i Kushtetutës, pasi neni 8 i aktit normativ parashikon se Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme janë pjesë e Komitetit Kombëtar për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar, i cili është një strukturë që drejtohet nga ministri i Brendshëm dhe që ka në përbërje funksionarë të tjerë pjesë të pushtetit ekzekutiv. Anëtarësia e dy përfaqësuesve të organit të ndjekjes penale krijon premisa për ndikim të papërshtatshëm ose për presion të fshehtë nga ekzekutivi. Ky akt i jep diskrecion absolut strukturës së posaçme, Operacionit Forca e Ligjit (*OFL*), duke i dhënë attribute për të identifikuar dhe verifikuar subjekte ndaj të cilave vendosen masat e kufizimit personal dhe ato pasuror, në një kohë që atributin e verifikimeve e kanë organet e pushtetit gjyqësor.
- 18.10. *Parimin e proporcionalitetit*, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi nuk respekton *elementin e domosdoshmërisë*, duke vendosur kufizime që krijojnë dyshime serioze që tejkalojnë përcaktimet e KEDNJ-së, të konsoliduara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), sikurse: *të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; *të drejtën për liri dhe siguri*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së; *të drejtën e lëvizjes*, të garantuar nga neni 2 i

Protokollit nr. 4, të KEDNJ-së; të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së; parimin e prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 2, i KEDNJ-së; të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së.

19. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, me shkresën nr. 471/1 prot., datë 03.03.2022, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur:

A. *Për legjitimimin e kërkuarit:*

- 19.1. Pretendimet e kërkuarit që lidhen me kushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar kanë rënë në dekadencë, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike para se t'i drejtohet Gjykatës, pasi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ai nuk ka ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por ka paraqitur vetëm pretendime në drejtim të cenimit të procesit të rregullt ligjor.
- 19.2. Kërkuari nuk legjitimohet për pretendimet për cenimin e parimeve themelore kushtetuese, të tilla si: hierarkia e akteve, ndarja dhe balancimi i pushteteve, si dhe pavarësia e GJKKO-së dhe Prokurorisë së Posaqme, pasi në cilësinë e subjektit të kushtëzuar mund t'i drejtohet Gjykatës vetëm për cenimin e të drejtave të tij kushtetuese.
- 19.3. Kërkuari nuk legjitimohet për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, pasi efektet e vendimit kanë përfunduar dhe së bashku me të edhe vlefshmëria e vetë normës, referuar nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000. Kështu, akti normativ nr. 1/2020, i ndryshuar nuk është më pjesë e sistemit juridik dhe mekanizmat e ngritur për zbatimin e tij kanë pushuar së vepruari në datën 31.12.2020, ndaj nuk sjell më pasoja dhe nuk mund të shqyrtohet. Kërkuari nuk është më subjekti i aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar dhe nuk vuan asnjë pasojë nga zbatimi i tij, pasi masa kufizuese ka përfunduar në datën 29.01.2022.
- 19.4. Kërkuari nuk legjitimohet për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të identifikimit të dispozitës konkrete, pasi kërkesa është ngritur në përgjithësi, pa evidentuar dhe analizuar dispozitën specifike që kundërshtohet dhe që sjell pasoja në drejtim të shkeljes së të drejtave

kushtetuese të kërkuesit. Për më tepër, kërkuesi ka ngritur pretendime ndaj masave parandaluese me karakter pasuror në drejtim të cenimit të së drejtës së pronës, e cila nuk rezulton të jetë dhënë në rastin e tij dhe çështja nuk është ngritur ndonjëherë për rishikim.

B. Për miratimin e akteve normative nr. 1/2020 dhe nr. 35/2020:

19.5. Kërkesa nuk është e bazuar, pasi procedura e miratimit të akteve normative ka qenë në përputhje me Kushtetutën dhe ndryshimet kanë qenë të nevojshme për shkak të pamundësisë objektive për të vlerësuar dhe gjykuar të gjitha kërkesat e depozituara deri në datën 31.12.2020.

C. Për vlerësimin e aktit normativ me nenin 101 të Kushtetutës:

19.6. Pretendimet e kërkuesit nuk janë të bazuara, sepse akti garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke u dhënë subjekteve të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

20. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, me shkresën nr. 704/1 prot., datë 03.03.2022, ka prapësuar vetëm në lidhje me pretendimet për antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, duke argumentuar:

A. Për legjitimimin e kërkuesit:

20.1. Pretendimet e kërkuesit që lidhen me antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar kanë rënë në dekadencë, pasi ato nuk janë ngritur prej tij në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke hequr dorë prej tyre, për rrjedhojë nuk duhet të merren në shqyrtim nga Gjykata.

20.2. Kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet në drejtim të cenimit të parimeve kushtetuese, të tilla si: hierarkia e akteve, ndarja dhe balancimi i pushteteve, si dhe pavarësia e GJKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme, pasi në cilësinë e subjektit të kushtëzuar mund t'i drejtohet Gjykatës vetëm për cenimin e të drejtave të tij kushtetuese, në përputhje me parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

20.3. Kërkuesi nuk legjitimohet për paraqitjen e ankimit kushtetues individual përkundrejt normës, pasi akti normativ nr. 1/2020, të ndryshuar nuk është më

pjesë e sistemit juridik dhe mekanizmat e ngritur për zbatimin e tij kanë pushuar së vepruari në datën 31.12.2020, ndaj nuk sjell më pasoja dhe nuk mund të shqyrtohet. Ndërsa masa e kufizimit ndaj kërkuetit ka mbaruar efektet maksimalisht në datën 29.01.2022 dhe në kohën e shqyrtimit të çështjes ndaj tij nuk është ushtruar asnjë masë kufizuese dhe nuk ka ardhur asnjë pasojë. Pra, në kushtet kur efektet e vendimit kanë përfunduar dhe së bashku me të edhe vlefshmëria e vetë normës, referuar nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkueti nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës.

- 20.4. Ai nuk legjitimohet për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, për shkak të mospërmbushjes së kriterit të identifikimit të dispozitës konkrete, pasi kërkesa është ngritur në përgjithësi, pa evidentuar dispozitat konkrete të aktit normativ dhe pa bërë një analizë të dispozitave specifike që kundërshtohen dhe që sjellin pasoja në drejtim të shkeljes së të drejtave kushtetuese të tij. Për më tepër, kërkueti ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së pronës, ndërkohë nuk rezulton që ndaj tij të jenë zbatuar masa parandaluese me karakter pasuror dhe çështja e tij nuk është ngritur ndonjëherë për rishikim.

B. Për kushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar:

- 20.5. Kërkueti nuk ka arritur të ngrejë në nivel kushtetues pretendimet e tij në lidhje me antikushtetutshmërinë e aktit normativ. Për më tepër, ndërhyrja me akt normativ për ligje nga problematikat e krijuara nga zbatimi i ligjit nr. 10192/2009 për shkak të reformës në drejtësi, si dhe nga mosfunksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit. Çdo masë parandaluese e parashikuar në aktin normativ nr. 1/2020, të ndryshuar i nënshtrohet vendimmarrjes nga organet gjyqësore, brenda afateve të arsyeshme, duke garantuar procesin e rregullt ligjor, në përputhje me garancitë e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ai respekton parimin e proporcionalitetit dhe paraqitet i harmonizuar me legjisllacionin vendas. Në rastin konkret ka pasur një dyshim të arsyeshëm për cenimin e rendit dhe të sigurisë juridike, duke e bërë të nevojshëm/domosdoshëm aplikimin e një mase të tillë. Për më tepër që aplikimi i masës ka ndjekur një rend proporcionaliteti, pasi ka qenë e aplikueshme vetëm për një vit dhe aktualisht nuk është në fuqi. Parë edhe nën

dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, këto pretendime nuk kanë të tillë rëndësi sa të vlerësohet cenimi i të drejtave të kërkuarit.

21. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, me shkresën nr. 970/1 prot/B.D., datë 02.03.2022, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, se:

21.1. Prokuroria e Posaçme dhe të tria gjykatat në vendimmarrje janë bazuar në parashikimet e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, të cilin nëse gjykatat do ta vlerësonin në kundërshtim me Kushtetutën, do të pezullonin gjykimin dhe do ta dërgonin çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër, procedimi parandalues është autonom në raport me procedimin penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ky ligj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

22. Kërkuari ka pretenduar se vendimet nr. 87, datë 29.01.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, nr. 99, datë 08.04.2021 të GJKKO-së së Apelit dhe nr. 00-2021-449, datë 22.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe janë bazuar në një akt normativ, i cili është i papajtueshëm me Kushtetutën. Ai kërkon shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të dhëna në një proces gjyqësor, në të cilin ai ka qenë palë, si dhe aktin normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, që është zbatuar gjatë këtij procesi.

23. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se kërkuari nuk legjitimohet plotësisht për pretendimet që lidhen me antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, pasi: (a) *nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion*, duke qenë se pretendimet nuk i ka bërë objekt kundërshtimi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ato kanë rënë në dekadencë; (b) *nuk legjitimohet racione materiae* për pretendimet në drejtim të cenimit të parimeve kushtetuese, të tilla si: hierarkia e akteve, ndarja dhe balancimi i pushteteve, si dhe pavarësia e GJKKO-së dhe Prokurorisë së Posaçme, duke qenë se përfshihet në kategorinë e subjekteve të kushtëzuara; (c) *në lidhje me ekzistencën e normës dhe çështjes*, akti nuk sjell më pasoja dhe nuk mund të shqyrtohet, sepse nuk është më pjesë e sistemit juridik dhe mekanizmat e ngritur për zbatimin e tij kanë pushuar së vepruari në datën 31.12.2020 dhe, për më tepër, masa e kufizimit ndaj tij ka mbaruar efektet,

maksimalisht, në datën 29.01.2022, duke bërë që në kohën e shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë ndaj kërkuarit të mos ushtrohej asnjë masë kufizuese dhe të mos kishte asnjë pasojë; (ç) *nuk ka identifikuar dispozitën konkrete të aktit normativ që kundërshton dhe që sjell pasoja në drejtim të shkeljes së të drejtave kushtetuese të tij. Ai ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së pronës, ndërkohë nuk rezulton që ndaj tij të jenë zbatuar masa parandaluese me karakter pasuror dhe çështja e tij nuk është ngritur ndonjëherë për rishikim.*

24. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se kërkuari me anë ankimit kushtetues individual kërkon: (i) shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë ardhur si rezultat i zbatimit të një akti normativ antikushtetues; (ii) shfuqizimin e vetë aktit normativ.

25. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

26. Bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kërkuari legjitimohet nëse plotëson bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (*shih vendimet nr. 4, datë 21.01.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Kriteret e lartpërmendura për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

28. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të saj, legjitimohet *ratione personae* për kërkimet sipas objektit të kërkesës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është zbatuar akti normativ i kundërshtuar, për rrjedhojë në momentin e paraqitjes së kërkesës ka pasur interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

29. Një tjetër kriter që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 23, datë 29.04.2021; nr. 54, datë 24.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll *subsidiar*, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Pra, para se kërkuesi t’i drejtohet Gjykatës, ai duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton se kërkuesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike “*efektive*” përpara se t’i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Ndërsa në lidhje me ankimin kushtetues individual me objekt kundërshtimin si antikushtetues të ligjit ose aktit normativ, Gjykata ka theksuar se kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato para gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjete juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë kuptim, edhe akti normativ duhet të jetë drejtpërdrejt i zbatueshëm, si dhe të mos parashikojë nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

32. Referuar përmbajtjes së akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues, Gjykata vëren se pretendimet që lidhen me antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, kërkuesi i ka parashtruar edhe më herët gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Konkretisht, në ankimin e paraqitur në datën 12.03.2021 kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 87, datë 29.01.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, pezullimin e gjykimit dhe referimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Këto kërkime nuk janë shqyrtuar nga GJKKO-ja e Apelit, me arsyetimin se mbrojtësit nuk kishin tagrin e nevojshëm për përfaqësim, pasi mungonte autorizimi i shprehur nga ana e kërkuetit. Në vijim, kërkuesi, nëpërmjet njërit prej mbrojtësve të tij, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë duke kërkuar prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues, pasi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e dy gjykatave më të ulëta. Sipas kërkuetit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, i ka kufizuar të drejtën e lëvizjes pas një gjykimi të zhvilluar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e tij. Ndërsa GJKKO-ja e Apelit, për shkak të pamundësisë së tij për të lëvizur si pasojë e masës kufizuese, i ka hequr mundësinë e vetme për t'u dëgjuar. Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi e ka vlerësuar të drejtë arsyetimin e GJKKO-së së Apelit lidhur me mungesën e shprehjes së vullnetit nga kërkuesi për

t'u përfaqësuar nga dy mbrojtësit dhe aplikimin e nenit 450 të KPC-së, referuar përcaktimeve të nenit 10 të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar.

33. Lidhur me prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, se kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet që lidhen me antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, të cilat kanë rënë në dekadencë, pasi ai nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, duke qenë se nuk i ka bërë objekt kundërshtimi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 23 të këtij vendimi*), Gjykata konstaton se është e vërtetë se kërkimi për kontrollin e kushtetutshmërisë së aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar ka qenë i specifikuar vetëm në objektin e ankimit drejtuar GJKKO-së së Apelit. Megjithatë, ajo vëren se pavarësisht se kërkuesi nuk e ka shprehur këtë kërkim në objektin e rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë, në përmbajtjen e tij ai ka pretenduar se humbja e së drejtës për t'u dëgjuar nga GJKKO-ja e Apelit në lidhje me themelin e ankimit ka ardhur për shkak të masës së kufizimit.

34. Gjykata ka pohuar se paraqitja e kërkesës për inicimin e kontrollit incidental të normës nuk përbën element të domosdoshëm në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, megjithatë si një formë jo e drejtpërdrejtë e aksesit në gjykimin kushtetues, palët në proces mund të zgjedhin t'i kërkojnë gjykatës së zakonshme që të investojë Gjykatën (*shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), sikurse ka vepruar në rastin në shqyrtim kërkuesi në ankimin drejtuar GJKKO-së së Apelit. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen në vend të të drejtave të cenuara është ankimi kushtetues individual, për rrjedhojë në çështjen konkrete përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

35. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Po kështu, neni 50, pika 4, e po këtij ligji parashikon se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën, ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Pra, në rastin e ankimit kushtetues individual konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ.

36. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se momenti që sjell cenimin e të drejtave dhe lirive themelore, për rrjedhojë lindjen e së drejtës së kërkuesit për të paraqitur ankim kushtetues individual, lidhet me datën e publikimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Konkretisht, vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 22.06.2021, por kancelari i asaj gjykate ka informuar kërkuesin se “...informacioni mbi përfundimin e çështjes është publikuar brenda datës 22.06.2021, datë vendimmarrje nga Kolegji penal dhe vendimi përfundimtar është publikuar në datën 23 korrik 2021”. Në kushtet kur në ankimin kushtetues kërkuesi ngre pretendime që sipas tij duhet të ishin shqyrtuar dhe të kishin marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë, momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese konsiderohet data 23.07.2021, në të cilën vendimi përfundimtar është bërë efektivisht i disponueshëm për kërkuesin dhe ai është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate. Ankimi kushtetues individual është dërguar me postë në Gjykatë në datën 23.11.2021, brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga nenet 71/a, pika 1, shkronja “b” dhe 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

37. Në analizë të përmbushjes së kriterit për legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, një kusht tjetër për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual lidhet me përmbajtjen e pretendimeve të parashtruara.

38. Në këtë drejtim, kërkuesi ka pretenduar antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore, pasi ato i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe janë bazuar në një akt normativ të papajtueshëm me Kushtetutën, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë cenuar të drejtën për t’u dëgjuar, për akses dhe për të marrë pjesë personalisht në proces. Sipas kërkuesit, kufizimi i lirisë në aspektin e së drejtës së lëvizjes është një masë që jepet vetëm në kuadër të një procesi penal. Kurse akti normativ nr. 1/2020, i ndryshuar bie në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, bie në kundërshtim me procedurën kushtetuese për miratimin e tij dhe me hierarkinë e akteve, sipas përcaktimeve të nenit 116 të Kushtetutës, zgjeron kompetencat e Prokurorisë së Posaçme përtej atyre të parashikuara nga nenet 148/dh dhe 135, pika 2, të Kushtetutës, bie në kundërshtim me parimin kushtetues të pavarësisë së prokurorisë, të parashikuar nga neni 148, pika 2 i Kushtetutës, si dhe me parimin e proporcionalitetit në

kufizimin e disa të drejtave dhe lirive themelore të KEDNJ-së dhe protokolleve shtesë të saj, si: të drejtën e pronës, të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën e lëvizjes, të drejtën për proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, si dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të garantuara nga nenet 27, 30, 41 dhe 42 të Kushtetutës, nenet 5, 6 dhe 8 të KEDNJ-së, neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

39. Gjykata evidenton se pretendimet e kërkuarit si ndaj vendimeve gjyqësore, ashtu dhe ndaj aktit normativ janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës.

40. Për sa u përket prapësimeve të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, se kërkuari nuk legjitimohet për pretendimet që lidhen me antikushtetueshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, pasi nuk *ekziston as norma, as çështja*, duke qenë se akti nuk është më pjesë e sistemit juridik dhe masa e kufizimit ndaj tij i ka mbaruar efektet, *nuk ka identifikuar dispozitën konkrete* të aktit normativ që kundërshton dhe ka ngritur pretendime që shkojnë përtej llojit të masës së aplikuar në rastin e tij (*shih paragrafin 23 të këtij vendimi*), Gjykata fillimisht vëren se në zbatim të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur ndaj kërkuarit masën parandaluese personale të kufizimit të perimetrit të lëvizjes me afat 1 - vjeçar, e cila ka përfunduar së ekzekutuari në datën 16.02.2022, pra efektet e kësaj mase parandaluese tashmë janë shuar (*shih paragrafët 16 - 17 të këtij vendimi*).

41. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së aktit normativ nr. 1/2020, Gjykata konstaton se ai ka efekt të përkohshëm dhe zbatohet deri më 31.12.2020 (*neni 38*). Ndërkohë që akti normativ nr. 35/2020 ka shtyrë kohën e shtrirjes së efekteve të aktit normativ nr. 1/2020, duke përcaktuar *“vazhdimin e shqyrtimit nga prokuroria dhe gjykata të kërkesave të depozituara nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në datën 31.12.2020” (neni 1)*. Kjo do të thotë se akti normativ nr. 1/2020 vazhdon të ketë efekte për procedurat që janë në proces shqyrtimi gjyqësor edhe pas datës 31.12.2020.

42. Nga ana tjetër, ligji nr. 8577/2000 përcakton në nenin 51, pika 2, të tij se kur një ligj ose akt normativ ose pjesë të tij, që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, shfuqizohen ose ndryshohen para se kjo Gjykatë të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror. Bazuar në rrethanat konkrete të çështjes, Gjykata konstaton se rasti në shqyrtim

nuk hyn në situatën e nenit 51, pika 2, të sipërcituar, për shkak se akti normativ nr. 1/2020, jo vetëm që vazhdon të ketë efekte për procedurat që janë në proces shqyrtimi gjyqësor (*shih paragrafin 41 të këtij vendimi*), por ai ka prodhuar efekte edhe ndaj kërkuesit, duke qenë se vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e zbatimit të tij.

43. Në vijim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore, të bazuara në aktin normativ nr. 1/2020, janë të lidhura ngushtësisht njëra me tjetrën, për rrjedhojë kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* t'i drejtohet asaj për cenimin e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara nga Kushtetuta sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të saj. Prandaj, më poshtë do të analizohet themeli i pretendimeve të tij, por duke mbajtur në konsideratë rrethanat mbizotëruese të çështjes, të cilat pavarësisht se aktualisht nuk i kufizojnë atij të drejtën e lëvizjes, në parim, ato nuk janë të mjaftueshme për t'i mohuar shqyrtimin dhe vlerësimin e cenimit të mundshëm të të drejtave të tij kushtetuese.

B. Për themelin e pretendimeve

44. Gjykata, paraprakisht, evidenton se çfarëdolloj vlerësimi për themelin e pretendimeve që lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesit nga gjykatat, në të cilin është zbatuar akti normativ i kundërshtuar, nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për të, duke qenë se thelbi i këtyre pretendimeve lidhet me vendosjen e një mase parandaluese të padrejtë, ekzekutimi i së cilës ka përfunduar në datën 16.02.2022 (*shih paragrafin 40 të këtij vendimi*).

45. Megjithatë, duke qenë se vendimet e gjykatave të zakonshme kanë kufizuar lirinë personale të kërkuesit, nisur dhe nga rëndësia e veçantë që merr kjo e drejtë themelore kushtetuese, me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe për të parandaluar shkeljen e tyre eventuale në të ardhmen në proceset gjyqësore, Gjykata çmon të arsyeshme të shqyrtojë në themel pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

46. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të kërkuesit që lidhen me antikushtetutshmërinë e aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, duke qenë se aktualisht masa parandaluese e caktuar ndaj tij në zbatim të aktit normativ, sikurse u argumentua më sipër (*shih paragrafët 44 dhe 40 të këtij vendimi*), ka përfunduar, Gjykata nuk do të ndalet në shqyrtimin e tyre.

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

47. Kërkuesi pretendon se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për akses në gjykatë, të drejtën për të marrë pjesë personalisht në proces dhe të drejtën për t'u dëgjuar, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si pasojë e zbatimit të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e tij. Këto të drejta janë cenuar edhe nga GJKKO-ja e Apelit, pasi ajo ka mbajtur një qëndrim tejet formalist dhe ka shpërfillur çdo kërkesë të mbrojtësve dhe pse ishte shkalla e parë *de facto* ku kërkuesi mund t'i ushtronte ato. GJKKO-ja e Apelit kishte detyrimin të bënte një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për faktin nëse ishte lëshuar ose jo prokurë, duke qenë se sekretaria e GJKKO-së së Shkallës së Parë e kishte pranuar ankimin dhe kishte kryer veprimet përkatëse të përcjelljes së ankimit. Për më tepër, edhe gjykimi në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomë këshillimi, duke mos i dhënë mundësi shërimi parregullsive të procesit, të cilat sjellin pavlefshmërinë absolute të tij.

48. Sipas kërkuesit, duke qenë se ai gjendej nën masën e kufizimit të perimetrit të lëvizjes, pavarësisht dëshirës së tij, e kishte të pamundur objektivisht paraqitjen në seancë pa një fletëthirrje zyrtare nga gjykata e apelit, e cila përmes interpretimit të ngushtë të dispozitave ligjore dhe shpërfilljes së situatës së kërkuesit i ka mohuar atij të drejtën për t'u mbrojtur. Po kështu, e njëjta prokurë e posaçme i është bashkëlidhur edhe rekursit të depozituar në Gjykatën e Lartë, çka duhet të ishte e mjaftueshme së paku *ex post* nga ajo gjykatë që të konkludonte se ankimi ishte paraqitur nga mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi dhe të konstatonte pamundësinë e tij që të dëgjohej dhe të mbrohej përpara GJKKO-së së Apelit.

49. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave dhe Prokuroria e Posaçme, ndonëse nuk kanë prapësuar drejtpërdrejt pretendimet e kërkuesit për procesin gjyqësor, kanë parashtruar se vendimmarrja e gjykatave është bazuar në aktin normativ të kundërshtuar, i cili garanton të drejtën e subjekteve të tij për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

50. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se, në thelb, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke mos i dhënë mundësi të mbrohet efektivisht dhe të ushtrojë të drejtën e kontradiktoritetit në gjykim, pra të ketë akses në gjykatë, të dëgjohej dhe të marrë pjesë personalisht në procesin që po zhvillohet ndaj tij.

51. Në kuadër të garantimit të një gjykimi të drejtë, e drejta e kërkuesit për akses dhe për të marrë pjesë në gjykim është e lidhur ngushtësisht me ushtrimin e të drejtave të tij për t'u

dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Këto standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve (*shih vendimin nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Për rrjedhojë, në zbatim të parimit *iura novit curia*, Gjykata vlerëson të analizojë pretendimet e ngritura nga kërkuesi për vendimet gjyqësore në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë, si pjesë thelbësore e procesit të rregullt ligjor, duke qenë se cenimi i kësaj të drejte ndikon edhe në elemente të tjera, të tilla si e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve.

53. Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 12, datë 15.02.2017; nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 67, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohet kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 5, datë 02.03.2011; nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata konstaton se procesi në GJKKO-në e Shkallës së Parë është zhvilluar në dhomë këshillimi, ndërsa shqyrtimi i ankimit në GJKKO-në e Apelit është zhvilluar në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e prokurorit dhe të mbrojtësit ligjor. Në seancën e datës 29.03.2021, GJKKO-ja e Apelit ka konstatuar se ankimi ishte nënshkruar vetëm nga mbrojtësit ligjorë dhe nuk kishte të bashkëlidhur prokurën e

posaçme. Nga ana e mbrojtësit të kërkuesit është bërë me dije se ky dokument është depozituar së bashku me ankimin, prandaj GJKKO-ja e Apelit ka vendosur shtyrjen e seancës, duke i dhënë atij 10 ditë kohë për të rregulluar këtë të metë. Në seancën e datës 08.04.2021, mbrojtësi ligjor i ka bërë me dije gjykatës se noteri kishte vënë në dispozicion gabimisht prokurën e posaçme që i takonte vëllait të kërkuesit dhe se vetë kërkuesi nuk kishte mundur të paraqitej në seancë, sepse organet e policisë nuk i ishin përgjigjur kërkesës së tij për të ardhur në gjykim. Ai ka kërkuar disa minuta kohë për të paraqitur prokurën e duhur ose për të njoftuar përsëri kërkuesin. Po në këtë seancë, GJKKO-ja e Apelit, bazuar në nenin 450, pika 1, shkronja “ç”, të KPC-së, ka vendosur mospranimin e ankimit, pasi ka konkluduar se mbrojtësit ligjorë nuk kanë respektuar dispozitat ligjore për ankimin, sipas përcaktimeve të nenit 10 të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar dhe nenit 453 të KPC-së. Ndërsa, Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar rekursin në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se rekursi i ka përmbushur kriteret formale - procedurale, por nuk përmban asnjërin prej rasteve të parashikuara për pranueshmërinë e tij, sipas përcaktimeve të nenit 472 të KPC-së (*shih paragrafët 15 dhe 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

56. Po kështu, Gjykata vëren se bashkëlidhur rekursit të paraqitur nga avokat Arben Qeleshi gjendet prokura e posaçme e datës 16.02.2021, e nënshkruar nga kërkuesi, i cili ka autorizuar mbrojtësit ligjorë që të ushtrojnë në emër të tij edhe të drejtën e ankimit dhe të rekursit. Prokura e posaçme e datës 16.02.2021 është hartuar dhe nënshkruar pas dhënies së vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë (29.01.2021) dhe përpara datës së paraqitjes së ankimit ndaj këtij të fundit (12.03.2021), për rrjedhojë edhe përpara dhënies së vendimit të GJKKO-së së Apelit (08.04.2021).

57. Nga sa më sipër, bazuar edhe në dispozitat procedurale civile që parashikojnë të drejtën e ankimit dhe të zbatueshme në rastin në shqyrtim, Gjykata evidenton se kërkuesi ka shprehur në mënyrë të qartë vullnetin për përfaqësim dhe tagrat e dhëna mbrojtësve ligjorë. Ankimi është paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë, e cila së bashku me aktet e çështjes ia ka dërguar atë GJKKO-së së Apelit. Në kushtet kur gjykata e shkallës së parë e ka pranuar ankimin e paraqitur nga mbrojtësit dhe e ka përcjellë atë në gjykatën e apelit, ajo prezumohet se ka verifikuar paraprakisht elementet formale, përmbajtjen dhe dokumentet bashkëlidhur ankimit, përfshirë edhe ekzistencën e prokurës së posaçme.

58. Ndërkohë, pavarësisht se e njëjta prokurë e posaçme autorizonte mbrojtësit ligjorë për të ushtruar si ankimin, ashtu edhe rekursin në emër të kërkuesit, Gjykata e Lartë duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në drejtim të vërtetimit nëse e njëjta prokurë ishte paraqitur më herët në GJKKO-në e Shkallës së Parë. Thënë ndryshe, Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar nëse GJKKO-ja e Shkallës së Parë kishte treguar kujdesin e duhur në dërgimin e ankimit dhe dokumenteve që i bashkëngjiten atij në gjykatën kompetente ose nëse mbrojtësit e kërkuesit përmbushnin kriteret ligjore për paraqitjen e ankimit. Edhe në këtë këndvështrim, Gjykata thekson se ligji u ka dhënë gjykatave të zakonshme instrumentet e nevojshme për shmangien e veprimeve ose faktorëve që ndikojnë në mosrespektimin nga ana e mbrojtësve ligjorë të detyrave të tyre, qoftë edhe për shkak të pakujdesisë, të cilat në analizë të fundit të ecurisë së procesit nuk mund të rëndojnë ose cenojnë thelbin e së drejtës së mbrojtjes së individit, për më tepër kur individit i është kufizuar e drejta e lëvizjes.

59. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 83, datë 26.12.2017; nr. 65, datë 16.10.2017; nr. 58, datë 24.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, të cilat lidheshin me cenimin e procesit të rregullt ligjor në gjykatën e apelit, sikurse e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe e drejta e ankimit, në kushtet kur cenimi i këtyre të drejtave ishte pasojë e një akti normativ për të cilin ai kishte kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë, ajo nuk ka garantuar të drejtën e kërkuesit për akses në gjykatë. Në këtë situatë Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të së drejtës për akses në gjykatë, gjatë gjykimit të rekursit, është i bazuar.

60. Megjithatë, ndonëse pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar, Gjykata evidenton se dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesin (*shih paragrafin 44 të këtij vendimi*), pasi masa parandaluese e kufizimit të lëvizjes është ekzekutuar (*shih paragrafin 40 të këtij vendimi*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor.

61. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit të rekursit ndaj vendimit nr. 99, datë 08.04.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të së drejtës për akses në gjykatë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të rekursit ndaj vendimit nr. 99, datë 08.04.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.05.2022

Shpallur më 22.06.2022

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët në pakicë, kemi votuar për rrëzimin e kërkesës, pasi kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae*, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, të ndryshuar, shkronjat “c” dhe “ç”, ku parashikohet: “*Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur: c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin; ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.*”

2. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës “Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë”.

3. Bazuar në përmbajtjen e normës kushtetuese dhe të normave ligjore të detajuara për ankimin kushtetues individual, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese, pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur (*ratione materiae*).

4. Sipas jurisprudencës kushtetuese, për sa i përket kriterit të legjitimitetit *ratione materiae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, në lidhje me përmbajtjen e pretendimeve të ngritura në ankimin kushtetues individual, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Cenimi i të drejtave themelore duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe real, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e një shkeljeje dhe se preket drejtpërdrejt (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr.14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në vlerësimin tonë, pretendimet e kërkuesit për procesin e rregullt duhen vlerësuar edhe analizuar në kontekstin e statusit të kërkuesit (viktimë e shkeljes), ndaj të cilit, në zbatim të aktit normativ nr. 1/2020, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 87, datë 29.01.2021, ka vendosur masën parandaluese me natyrë personale të kufizimit të perimetrit të lëvizjes me afat 1-vjeçar, për shkak të dyshimit të ngritur për mundësinë e pjesëmarrjes së tij në kryerjen e krimeve të rënda, me qëllim garantimin e sigurisë publike dhe mundësinë e parandalimit të rrezikut për cenimin e saj.

6. Ndërkohë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se “Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë, duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese” (*shih vendimin nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Për sa më lart, për nevoja të këtij gjykimi, është administruar shkresa nr. 2815/1 prot., datë 12.04.2022 e Prokurorisë së Posaçme, nga ku rezulton se ekzekutimi i vendimi nr. 87, datë 29.01.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë është përmbushur në datën 17.02.2021. Po ashtu, në datën 20.05.2022, Komisariati i Policisë Krujë i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës ka informuar në rrugë elektronike se efektet e masës së sigurimit personal të kufizimit të lëvizjes të vendosur ndaj kërkuesit kanë përfunduar në datën 16.02.2022. Referuar këtyre të dhënave rezulton se efektet e masës parandaluese të lartpërmendur janë shuar për shkak të kalimit të afatit 1-vjeçar (17.02.2021-16.02.2022).

8. Për rrjedhojë, në vështrim të fakteve të sipërcituara të natyrës kushtetuese, shkeljet e pretenduara nuk mund të konsiderohen aktuale e për më tepër vazhduese, pasi nuk jemi para kufizimit të mëtejshëm të së drejtës për lëvizje të kërkuesit dhe ky i fundit e ka humbur statusin e viktimës në gjykimin kushtetues. Në këtë vështrim, jemi edhe kundër argumentit të shumicës, sipas të cilës, do të analizohet themeli i pretendimeve të kërkuesit, por duke mbajtur në konsideratë rrethanat mbizotëruese të çështjes, të cilat pavarësisht se aktualisht nuk i kufizojnë atij të drejtën e lëvizjes, në parim, ato nuk janë të mjaftueshme për t'i mohuar shqyrtimin dhe vlerësimin e cenimit të mundshëm të të drejtave të tij kushtetuese. (*shih paragrafin 43 të vendimit*). Argumenti se nuk janë të mjaftueshme rrethanat mbizotëruese të çështjes për t'i mohuar kërkuesit shqyrtimin në themel të saj, është evaziv, nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të analizuar në vijim të kësaj pakice, dhe për më tepër e kthen procedurën e kërkuar sipas nenit 42 të Kushtetutës si qëllim në vetvete, dhe jo si garanci procedurale, që si qëllim kryesor ka mbrojtjen e të drejtave substanciale kushtetuese, që në rastin konkret është e drejta e lëvizjes lirish të kërkuesit.

9. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimin kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa në nenin 48/1 të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar, parashikohet se “kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të”.

10. Në çështjen konkrete kërkuesi ka pasur si objekt: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 87, datë 29.01.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 99, datë 08.04.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2021-449, datë 22.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si

të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i aktit normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, i ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”. Ndërsa, shkaqet janë ato të përmendura në vendim dhe konkretisht për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore nga kërkuesi pretendohet: *cenimi i së drejtës për akses në gjykatë, për të marrë pjesë në proces dhe për t’u dëgjuar*, pasi gjykimi në GJKKO-në e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimi, kurse GJKKO-ja e Apelit i ka mohuar edhe *të drejtën e ankimit*, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës. GJKKO-ja e Apelit kishte detyrimin të bënte një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi faktin nëse ishte lëshuar apo jo prokurë, duke qenë se sekretaria e GJKKO-së së Shkallës së Parë e kishte pranuar ankimin dhe kishte kryer veprimet përkatëse të përcjelljes së ankimit. Kërkuesi duke qenë nën masën e kufizimit të perimetrit të lëvizjes, pavarësisht dëshirës së tij, e kishte të pamundur objektivisht paraqitjen në seancë pa një fletëthirrje zyrtare nga gjykata. E njëjta prokurë e posaçme i është bashkëlidhur edhe rekursit të depozituar në Gjykatën e Lartë, çka duhet të ishte e mjaftueshme për këtë gjykatë për të konkluduar se ankimi ishte paraqitur nga mbrojtësit e zgjedhur nga kërkuesi dhe se kërkuesi e kishte të pamundur të dëgjohej dhe të mbrohej përpara GJKKO-së së Apelit; *-cenimi i së drejtës për liri dhe siguri*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi mungojnë kushtet për legjitimitimin e kufizimit, duke qenë se masa e kufizimit të lëvizjes jepet vetëm në kuadër të një procesi penal; *- cenimi i së drejtës së mbrojtjes efektive*, pasi Gjykata e Lartë kishte detyrimin të konstatonte shkeljen e së drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor dhe si gjykatë ligji kishte të drejtë të konstatonte edhe kryesisht shkeljet e rënda të normave procedurale (*shih paragrafët 18.1.-18.3 të vendimit*).

11. Duke iu referuar vendimit, konstatohet se shumica ka analizuar: “Megjithatë, ndonëse pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar, Gjykata evidenton se dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesin, pasi masa parandaluese e kufizimit të lëvizjes është ekzekutuar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor (*shih paragrafin 60 të këtij vendimi*). Po ashtu, ajo ka vendosur: “ Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të rekursit ndaj vendimit nr. 99,

datë 08.04.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. 2. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera...” (*shih dispozitivin e vendimit*).

12. Për sa më lart, konstatohet se shumica nuk u është përmbajtur kërkimeve për shfuqizimin e vendimeve, sipas objektit, ndërkohë që shkeljen procedurale e ka lidhur vetëm me procesin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë të datës 22.06.2021, duke e lënë kështu të paqartë mundësinë e korrigjimit të shkeljes nga kjo gjykatë tashmë nën dritën e rrethanave të reja mbi çështjen që lidhen me mbarimin e efekteve të kufizimit të lëvizjes së kërkuarit, dhe duke vënë në dyshim edhe vetë efektivitetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo mungesë koherence mes arsyetimit dhe dispozitivit shoqëron edhe këtë të fundit, ku nuk pasqyrohet detyrimi për shqyrtimin e çështjes nga gjykatat më të ulëta, konkretisht Gjykata e Lartë.

13. Neni 76, pika 6, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, me ndryshimet përkatëse, parashikon se “vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga momenti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i së cilës është shfuqizuar”. Po ashtu, në pikën 5 të po të njëjtit nen parashikohet se “kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të një çështjeje, konstaton se ka boshllëk ligjor, si rrjedhojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, veç të tjerave, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar”. Ndërsa, në nenin 81, pika 3, të po këtij ligji parashikohet se “Gjykata Kushtetuese, në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit”.

14. Nga dispozitat ligjore të sipërpërmendura kuptohet se *si rregull* kur kërkuarit i drejtohen përmes ankimit kushtetues individual, Gjykata Kushtetuese shfuqizon dhe korrigjon shkeljen përmes kthimit të çështjes për shqyrtim pranë gjykatave të zakonshme, ndërsa *si përjashtim* ajo mund të japë edhe vendime konstatuese. Rasti konkret, me dispozitiv vetëm të natyrës konstatuese të shkeljes, nuk i përket as kategorisë së çështjeve ku gjykata konstaton kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit ligjor dhe urdhëron përshpejtimin e gjykimit të çështjes (*shih vendimin nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*) as atyre ku konstaton boshllëk ligjor (*supra, neni 76, pika 5*). Ndërkohë, theksojmë se nuk jemi para llojit të ndonjë vendimi dhe para ndonjë nevoje të tillë që të caktohet edhe mënyra e ekzekutimit të vendimit për organet publike. Edhe pse konstatimi i shkeljes është realizuar vetëm për procesin në Gjykatën e Lartë,

shumica nuk ka mundur të vazhdojë me qartësimin e këtij lloj dispozitivi për Gjykatën e Lartë, së cilës *si rregull* duhet t'i kthente çështjen për shqyrtim ose eventualisht të parashikonte urdhërimin e veprimeve të mëtejshme nga ndonjë organ tjetër publik për ekzekutimin e vendimit, me qëllim riparimin e pasojave të shkeljes dhe korrigjimin e situatës për aq sa është e mundur.

15. Si konkluzion, duke qenë se në vlerësimin tonë si gjyqtarë në pakicë, *së pari*, pasojat negative të pretenduara nga kërkuesi nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë më aktuale, por edhe sepse, *së dyti*, shqyrtimi i çështjes nga kjo Gjykatë nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të tij, në këtë gjykim do të duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës, në tërësi.

Anëtarë: Altin Binaj, Elsa Toska